



Pranuar / Dorezuar Prinjenol/Prudato Received/Delivety	25.09	3	viti god year
Organ /Mjesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKANSHUK	6243/2023		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1100/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari-dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, si dhe Vjollca Sinani -Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1100/2023 të datës 21.08.2023 të parashtruar nga ankuesi , nga , kundër organit të punësimit Komunës së Obiliqit, në çështjen juridike "Kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 25.09.2023,mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.1100/2023 e datës 21.08.2023, e parashtruar nga ankuesi .

A r s y e t i m

Nëpunësi civil . (tje ankuesi) i punësuar në Komunën e Obiliqit, më datë 21.08.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për kompensim në mënyrë retroaktive të mjeteve të papaguara në emër të vendimit nr.11-107 i datës 08.02.2018 për caktim në pozitën shtëpiak në Komunën e Obiliqit edhe atë nga viti 2018 deri më 07.08.2023.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje referuar vetëm Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 25.08.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Obiliqit, ndërsa kjo e fundit me datë 21.09.2023 ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e shqyrtimit të kësaj ankese ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 1100/2023 të datës 21.08.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Përgjigjen në kërkesën të ankuesit me nr.483 e datës 04.08.2023; Kërkesë për kompensim e orëve të punës e datës 10.07.2023; Akt emërimi me nr.II/37 i datës 03.01.2013; Vendimi me nr.II/1085 e datës 07.08.2023; Raporti javor i datës 05.11.2018; Raporti javor i datës 12.11.2018; Raporti javor i datës 19.11.2018; Raporti javor i datës 29.10.2018; Raporti javor i datës 26.11.2018; Raporti javor i datës 21.01.2019; Raporti javor i datës 28.01.2019; Raporti javor i datës 04.02.2019; Raporti javor i datës 04.03.2019; Raporti javor i datës 18.03.2019; Raporti javor i datës 25.03.2019; Raporti javor i datës 01.04.2019; Raporti javor i datës 08.04.2019; Raporti javor i datës 08.07.2019; Raporti javor i datës 13.01.2020; Raporti javor i datës 06.07.2020; Raporti javor i datës 13.07.2020; Raporti i datës 17.03.2021; Raporti i datës 25.05.2021; Raporti i datës 17.08.2021; Raporti i datës 07.03.2022; Email i datës 28.01.2022; Email i datës 28.01.2022; Vendim me nr.II/107 i datës 08.02.2018; Marrëveshje për punë me vëllim të shtuar me nr.II/1087 e datës 07.08.2023; Kopja e letërnjoftimit e ankuesit; Kërkesën për përgjigje e datës 25.08.2023; Përgjigjen në ankesë nga organi i punësimit e datës 21.09.2023; Përshkrimi i detyrave të Punës; Formular kërkesë me nr.Prot. -II- 17842/23 i datës 10.07.2023; Lista e pagave 01.10.2021 deri 31.10.2021; Lista e pagave 01.12.2022 deri 31.12.2022.

Kolegji i këshillit duke u bazuar provat që gjenden në shkresat e lëndës konstatoi se ankesa e ankuesit është e pa lejuar, sepse:

Nga provat e administruara të lëndës rrjedhë së ankuesi është i punësuar në Komunën e Obiliqit në pozitën e punës "Nëpunës - Anketues" në kuadër të Drejtorisë së Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit, sipas akt emërimit me nr.II/37 e datës 03.01.2013, ndërsa sipas Marrëveshje për punë me vëllim të shtuar me nr.II/1087 e datës 07.08.2023 i njëjti është caktuar edhe në pozitën "Shtëpiak në Komunën e Obiliqit".

Ankuesi me datë 10.07.2023 ka parashtruar kërkesë te organi i punësimit për kompensim në mënyrë retroaktive të mjeteve të papaguara në emër të punëve shtesë sipas vendimit Nr.II-107 të datës 08.02.2018 dhe atë kompensimin për periudhën 08.02.2018 deri më 07.08.2023. Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim me datë 04.08.2023 i përgjigjet ankuesit me shkresë me arsyetimin se ankuesi nuk ka raport të punës sa i përket punëve shtesë për periudhën nga viti 2018 e deri më sot.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon që ti njihet e drejta për kompensim në mënyrë retroaktive të mjeteve të papaguara në emër të Vendimit për ngarkimin e një detyre shtesë si Shtëpiak në ndërtesën e Komunës së Obiliqit dhe atë nga 08.02.2018 deri më 07.08.2023, sipas vendimit Nr.II-107 të datës 08.02.2018.

Kolegji i Këshillit shqyrtoj pretendimin ankimor të ankuesit lidhur me kompensimin në mënyrë retroaktive dhe si rrjedhojë konstatoi se pretendimi ankimor i ankuesit si i tillë nuk është i bazuar, ngase sipas shkresave të administruara të lëndës rrjedh se ankuesi nuk ka ber asnjë veprim juridik-administrativë që nga viti 2018 e deri me 10.07.2023 në kuptim të kompensimit të mjeteve për punë shtesë, duke vepruar kështu në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e

Përgjithshme Administrative, nenin 124 paragrafi 1, i cili përcakton se: "1.Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim..." nenin 125 paragrafi 1 të këtij ligji ku përcaktohej se: "Përpos nëse është paraparë ndryshe me ligj, ankesa mund të parashtrohet kundër një akti administrativ apo ndaj mosveprimit të organit publik brenda afatit të përcaktuar për përfundimin e procedurës administrative (në vijim: "heshtja administrative"),nenin 127 paragrafi 1 dhe 4 ku parashihet:" 1.Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ", dhe "4.Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ", mbi këtë bazë ligjore kolegji konstaton se me qenë se pretendimi i ankuesit është kompensimi shtesë sipas vendimit Nr.II-107 të datës 08.02.2018 atëherë mbi bazën e shkresave të lëndës të dërguara nga palët në procedurë konfirmohet fakti se ankuesi referuar këtij vendimi të apostrofuuar si më lartë për kompensimin me rastin punës shtesë e drejta e tij për të kërkuar kompensimin i ka rrjedhë nga muaji vijues përkatësisht 01.03.2018(nga momenti i njoftimit në lidhje me pagën e muajit 02/2018) mirëpo siç u tha më lartë deri më datë 10.07.2023,nuk ka ndërmarrë asnjë veprim dhe në këtë kuptim u vendosë si në dispozitiv të këtij vendimi.

Duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda,A.nr.1100/2023, datë 25/09/2023

Vjollca SINANI

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit,
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Obiliqit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

